VENDIM
Nr.59, datë 28.7.2010

PËR MOSZGJERIM ZONE LICENCIMI
PËR RADION VENDORE PRIVATE "RADIO DJ 96.1"
SUBJEKTIT: "RADIO LINK" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos zgjerojë zonën e licencimit të operatorit radiofonik privat vendor "Radio Dj 96.1", pasi, nga shqyrtimi i dokumentacionit për zgjerimin e zonës së licencimit, rezultoi se subjekti është gjetur në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së, në frekuencat 88 MHz dhe 90.7 MHz, në qytetet Fier dhe Vlorë; nuk identifikohet autori i projektit teknik; nuk është depozituar deklarata noteriale; nuk janë paraqitur të dhënat mbi numrin e punonjësve dhe organigrama, si dhe nuk është depozituar garancia bankare në masën 10% të kapitalit dhe nuk është kryer pagesa për përpunimin e dokumentacionit.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati